



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 985/prot.
3

Tiranë më 27.6.2018

Lënda: Në lidhje me kërkesën për opinion ligjor të paraqitur nga Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas.

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit vlerëson si të nevojshme tju informojë mbi kërkesën e Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ) për opinion ligjor lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve (ndër të tjera edhe nr. ID) në kuadër të zbatimit të Udhëzimit nr.3743, datë 10.7.2017 “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.436, datë 9.5.2018, miratuar nga ana juaj.

Në vijim, në kuadër të një vlerësimi sa më objektiv dhe të pranueshëm nga palët, Zyra e Komisionerit me shkresën nr. 985/1 prot, datë 20.06.2018, ju ka informuar mbi zhvillimin e një seance dëgjimore (në datën 26.06.2018, ora 10:00) ku është vlerësuar si e domosdoshme prania e përfaqësuesve të institucionit tuaj dhe Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas.

Gjatë këtij takimi, të zhvilluar në mungesë të përfaqësuesit të institucionit tuaj, Zyra e Komisionerit u njoh me specifikat e procesit dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave të qytetarëve, nga ana e përfaqësuesit të SHKTQ, duke patur si synim kryesor garantimin dhe respektimin e detyrimeve të parashikuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar.

Referuar Udhëzimit nr.3743, datë 10.7.2017 “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.436, datë 9.5.2018, Zyra e Komisionerit konstaton se në të parashikohet mbledhja dhe përpunimi i disa kategorish të dhënash personale të tilla si emër, mbiemër, fotografia, nr. ID, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në zbatim të nenit 31/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, ky akt nënligjor duhet

të ishte dërguar paraprakisht për mendim, pasi parashikon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve.

Në parim, përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohen një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Referuar kësaj dispozite akti që mund të legjitimojë një proces përpunimi të dhënash personale është vetëm në formën e ligjit.

Në pikën 1 të Udhëzimit parashikohet qëllimi:

"Ky udhëzim ka për qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të transportit publik dhe lehtësimin të procedurave për qytetarët, transparencën e përdorimit të këtyre shërbimeve, identifikimin e grupeve që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor dhe shmangies së evazionit fiskal".

Zyra e Komisionerit, pas analizimit të qëllimit të përpunimit të kategorive të të dhënave personale për subjektin e të dhënave "përdorues", parashikuar në këtë Udhëzim, vlerëson se përpunimi i të dhënave mbi nr. ID të përdoruesit është i tepërt dhe në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave personale, sanksionuar në nenin 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Qëllimi që synohet të realizohet nëpërmjet këtij Udhëzimi mund të arrihet edhe nëpërmjet përpunimit vetëm të kategorive të të dhënave personale si emri, mbiemri dhe fotografia e përdoruesit të biletës tatimore, duke patur në këtë rast një impakt më të vogël në privatësi.

Sa i përket detyrimeve të tjera që lindin në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit ka informuar në formë shkresore Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas.

Në përfundim, mbetemi të hapur për të bashkëpunuar me ju në kuadër të garantimit të të drejtës për privatësi të qytetarëve dhe ofrimin e një shërbimi cilësor.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

